

Në bazë të nenit 103 paragrafi 1 pika 2 dhe lidhur me nenet 149, 150 dhe 151 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 82/18), neni 200 paragrafi 1 alineja 1 nga statuti i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, e në lidhje me Vendimin e Drejtorisë rektoriale të Universitetit nr.02-742/2 nga data 19.04.2022, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për numrin e studentëve për regjistrim në vitin e parë në institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2023/2024 nr. 41-6059/5 i datës 27.07.2023 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/21), Vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për kuotat plotësuese për regjistrim të studentëve pjestarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin e parë në institucionet shtetërore të arsimit të lartë në vitin akademik 2023/2024 nr.41-6058/4 i datës 27.07.2023 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/21), , Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup shpall:

## KONKURS

### për regjistrimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve në programet studimore në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup në vitin akademik 2023/2024

#### I. NUMRI I STUDENTËVE

Në njësitë (fakultetet) e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në vitin e parë të ciklit të parë të studimeve në vitin akademik 2023/2024, do të mund të regjistrohet numri i studentëve si në vijim:

FAKULTETET DHE PROGRAMET STUDIMORE	Studentë të rregullt me kuotë shtetërore	Shuma e pagesës (Vjetore EURO)	Të rregullt me kofinansim	Shuma me kofinansim (Vjetore EURO)	Të çrregullt	Shuma me kofinansim (Vjetore EURO)	Numri i përgjithshëm I studentëve
<b>FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS</b>	<b>85</b>	200	<b>15</b>	<b>400</b>			<b>100</b>
Arkitekturë dhe dizajn (180 EKTC)	60	200	10	<b>400</b>			70
Ndërtimtari- konstruktive (180 EKTC)	25	200	5	<b>400</b>			30
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE INFORMATIKE</b>	<b>210</b>	<b>200</b>	<b>30</b>	<b>400</b>	<b>30</b>	<b>400</b>	<b>270</b>
Informatikë (240 EKTC)	60	200	10	<b>400</b>	10	<b>400</b>	80
Informatikë- mësimdhënie (240 EKTC)	20	200	5	<b>400</b>	5	<b>400</b>	30
Shkenca kompjuterike dhe inxhinierike (240 EKTC)	50	200	5	<b>400</b>	5	<b>400</b>	60
Programim i aplikuar (180 EKTC)	80	200	10	<b>400</b>	10	<b>400</b>	100
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE</b>	<b>210</b>	200	<b>70</b>	<b>400</b>	<b>40</b>	<b>400</b>	<b>320</b>
Elektroenergjetika dhe burimet e ripërtrishme të energjisë (240 EKTC)	25	200	5	<b>400</b>			30
Dizajni i qëndrueshëm në inxhinierinë makinerike (240 EKTC)	25	200	5	<b>400</b>			30
Inxhinieri e transportit dhe komunikacionit (240 EKTC)	30	200	30	<b>400</b>	10	<b>400</b>	70
Mekatronikë (180 EKTC)	20	200	5	<b>400</b>	5	<b>400</b>	30

Menaxhment industrial (240 EKTC)	30	200	5	400	5	400	40
Inxhinieria për mbrojtje të ambientit të punës dhe jetesës (240 EKTC)	30	200	5	400	5	400	40
Dogana, shpëdicion dhe sigurime (240 EKTC)	50	200	15	400	15	400	80
<b>FAKULTETI I SHKENACVE TEKNOLOGJIKE</b>	<b>130</b>	200	<b>60</b>	<b>400</b>			<b>190</b>
Dizajn i prodhimeve kimike dhe proceset (240 EKTC)	30	200	10	400			40
Teknologjia ushqimore (240 EKTC)	30	200	20	400			50
Inxhinieria Biokimike (240 EKTC)	30	200	10	400			40
Tekstil dizajn dhe modelimi (180/240 EKTC)	40	200	20	400			60
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE</b>	<b>295</b>	200	<b>80</b>	<b>400</b>	<b>75</b>	<b>400</b>	<b>450</b>
Punë dhe politikë sociale (240 EKTC)	35	200	5	400	10	400	50
Media dhe komunikim ndërkulturor (240 EKTC)	20	200	10	400	10	400	40
Sport dhe shkencat e sportit (240 EKTC)	40	200	20	400	10	400	70
Administratë publike dhe menaxhim me burimet njerëzore (240 EKTC)	40	200	15	400	15	400	70
Studimet politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (240 EKTC)	30	200	10	400	10	400	50
Ekonomi e zbatuar dhe ndërmarsi (240 EKTC)	90	200	10	400	10	400	110
Psikologji (240 EKTC)	40	200	10	400	10	400	60
<b>FAKULTETI JURIDIK</b>	<b>110</b>	200	<b>20</b>	<b>400</b>	<b>20</b>	<b>400</b>	<b>150</b>
Studimet e Drejtësisë (240 EKTC)	70	200	10	400	10	400	90
Kriminalistik (240 EKTC)	40	200	10	400	10	400	60
<b>FAKULTETI EKONOMIK</b>	<b>170</b>	200	<b>20</b>	<b>400</b>	<b>20</b>	<b>400</b>	<b>210</b>
Marketing dhe Menaxhment (240 EKTC)	80	200	10	400	10	400	100
Finansa dhe Kontabilitet (240 EKTC)	90	200	10	400	10	400	110
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE</b>	<b>120</b>	200	<b>20</b>	<b>400</b>	<b>20</b>	<b>400</b>	<b>160</b>
Gjuhë dhe Letërsi Angleze (240 EKTC)	30	200	5	400	5	400	40
Gjuhë dhe Letërsi Gjermane (240 EKTC)	30	200	5	400	5	400	40
Perkthim Shqip-Maqedonisht-Anglisht dhe anasjelltas (240 EKTC)	30	200	5	400	5	400	40
Perkthim Shqip-Maqedonisht-Gjermanisht dhe anasjelltas (240 EKTC)	30	200	5	400	5	400	40
<b>Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup</b>	<b>1330</b>		<b>315</b>		<b>205</b>		<b>1850</b>

1 Për programin studimor Sport dhe shkencat sportive kërkohet certifikat për gjendjen shëndetësore (vërtetim mjekësor)

#### SHËNIM:

Institucioni i Arsimit të Lartë sjell Vendim për numrin minimal të studentëve të regjistruar me qëllim që të fillojë me punë programi studimor. Nëse programi studimor, nuk fillon me punë, kandidatët do të mund të regjistrohen në programe tjera studimore. Mësimi do të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën maqedonase, në përputhje me numrin e kandidatëve të paraqitur.

## **II. Kushtet dhe kriteret për regjistrim**

1. Të drejtë regjistrimi për studimet e ciklit të parë (cikli i parë në studimet akademike dhe studime profesionale) kanë kandidatët që kanë dhënë maturën shtetërore ose maturë ndërkombetare.

2. Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve kanë edhe kandidatët me shkollim të mesëm katërvjeçar të cilët nuk kanë dhënë maturë shtetërore, respektivisht kanë përfunduar shkollimin e mesëm katërvjeçar para vitit akademik 2007/2008.

3. Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt të financuar nga shteti dhe studentë të rregullt me kofinansim të studimeve. Në studimet e ciklit të parë të fakulteteve mund të regjistrohen edhe studentë me korrespondencë, nëse këtë e mundëson karakteri i programit studimor.

4. Në studimet e ciklit të parë në fakultete mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët kanë të përfunduar arsimin e lartë ose shkollimin e lartë në fakultete ose shkolla të larta të ngjashme. Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, deri në 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt në fakultetet përkatëse të përcaktuar në Konkurs. Kandidatët nga paragrafi i mëparshëm regjistrohen sipas suksesit të arsimit paraprak. Ngjashmëritë i përcakton dhe publikon fakulteti. Kandidatët nga kjo pike regjistrohen me kofinansim të studimeve, si dhe kandidatët nga kapitulli V i Konkursit.

5. Mënyra e seleksionimit të kandidatëve do të kryhet varësisht nga lloji i programeve studimore në të cilat konkurojnë ata, edhe atë:

a) programe studimore ku seleksionimi i kandidatëve do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm;

b) programe studimore ku seleksionimi do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm dhe me kontrollim të talentit të kandidatëve. Kjo ka të bëjë me programet studimore me specifika të veçanta.

6. Kriter bazë për seleksionimin e kandidatëve për regjistrim të studimeve deridiplomike është suksesi i arritur në arsim të mesëm. Vlerësimi i suksesit të studentëve shprehet me pikë.

a) Në programet studimore ku seleksionimi kryhet vetëm përmes suksesit të arsimit të mesëm, kandidatët mund të fitojnë me së shumti **100 pikë**, edhe atë: suksesi i përgjithshëm në të gjitha lëndët merr pjesë me **60%**, ndërsa suksesi i arritur në maturën shtetërore merr pjesë me **40%**.

### **a.1) Llogaritja e pikëve nga suksesi i përgjithshëm**

Në programet studimore ku seleksionimi do të kryhet vetëm në bazë të suksesit të arritur në arsimin e mesëm, llogaritja e pikëve bëhet në këtë mënyrë:

- mbledhen të gjitha notat, të cilat janë të evidentuara në dëftesat e notave nga të gjitha vitet, shuma e përgjithshme e fituar pjesëtohet me numrin e notave, kështu që suksesi mesatar i fituar shumëzohet me numrin 12. Me këtë më së shumti mund të fitohen **60 pikë**.

### **a.2) Llogaritja e pikëve nga suksesi i arritur në maturën shtetërore**

- Për kandidatët të cilët kanë dhënë maturën shtetërore në vitin akademik 2023/2024 llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore sjell më së shumti **40 pikë** dhe realizohet në këtë mënyrë:

## **Për dy lëndët externe**

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë provimin e lëndës externe e cila është e përshtatshme me programin studimor ku kanë konkuruar, kah nota e çdo lënde externe i shtohet rangui i përqindjes së kandidatit (i shprehur në përqindje) për lëndën përkatëse të pjesëtuar me 20, dhe kandidatit për lëndën e përshtatshme i shumëzohet me 1.2.

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë provimin e lëndës externe e cila nuk është e përshtatshme me programin studimor ku kanë konkuruar, pikët e asaj lënde të fituara sipas metodologjisë se dhënë shumëzohen me faktor 0,9.

Në bazë të kësaj mund të fitohen më së shumti **24 pikë** për dy lëndët externe.

#### **Për dy lëndët interne**

- Nota e provimit të dhënë nga lënda interne në maturën shtetërore, e cila **është e përshtatshme** me programin studimor në të cilin kandidati ka konkuruar shumëzohet me koeficient 1,2
- Nota e provimit të dhënë nga lënda interne në maturën shtetërore, e cila **nuk është e përshtatshme** me programin studimor në të cilin kandidati ka konkuruar shumëzohet me koeficient 0,8.

Shuma e fituar në këtë mënyrë mblidhet.

Në bazë të kësaj mund të fitohen më së shumti **12 pikë** për dy lëndët e përshtatshme interne gjegjësisht **10 pikë** për një lëndë të përshtatshme dhe një lëndë jo të përshtatshme dhe **8 pikë** nga dy lëndë jo të përshtatshme.

#### **Për detyrën projektuese**

Nota e fituar në detyrën projektuese shumëzohet me koeficient prej 0.8. Mbi këtë bazë, mund të merren më së shumti **4 pikë**.

❖ Për kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollën e mesme në vitin shkollor 2019/2020 dhe nuk kane dhënë maturën shtetërore në përputhje me Dekretin me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të mesëm në kohë të gjendjes së jashtzakonshme, mblidhen të gjithë notat e regjistruara në dëftesat e të gjitha viteve, llogaria totale ndahet me numrin e notave dhe nota mesatare shumëzohet me 20, mbi këtë bazë mund të meren më së shumti **100 pikë**.

❖ Për kandidatët të cilët kanë dhënë maturën shtetërore në vitin akademik 2013/2014 deri në vitin shkollor 2018/2019 llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore sjell më së shumti **40 pikë** dhe realizohet në këtë mënyrë:

#### **Për tre lëndët externe:**

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë provimin e lëndës externe e cila **është e përshtatshme** me programin studimor ku kanë konkuruar, kah nota e çdo lënde externe i shtohet rangui i përqindjes së kandidatit për lëndën përkatëse të pjesëtuar me 20.
- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë provimin e lëndës externe e cila nuk është e përshtatshme me programin studimor ku kanë konkuruar, pikët e asaj lënde të fituara sipas metodologjisë së sipërme, shumëzohen me faktor 0,5.

Në bazë të kësaj mund të fitohen më së shumti **30 pikë** nga tre lëndët externe.

#### **Për lëndën interne:**

Nota e provimit të dhënë të lëndës interne në maturën shtetërore, e cila është e përshtatshme me programin studimor në të cili kandidati ka konkuruar shumëzohet me koeficient 1,2.

- Nota e provimit të dhënë të çdo lënde interne në maturën shtetërore, e cila nuk është e përshtatshme me programin studimor në të cilin kandidati ka konkuruar shumëzohet me koeficient 0,8.

Në bazë të kësaj mund të fitohen më së shumti **6 pikë** për lëndë të përshtatshme interne, përkatësisht **4 pikë** për një lëndë të pa përshtatshme interne.

#### **Për detyrën projektuese**

Nota e fituar në detyrën projektuese shumëzohet me koeficient prej 0.8. Mbi këtë bazë, mund të merren më së shumti **4 pikë**.

❖ Për kandidatët të cilët kanë dhënë maturën shtetërore pas vitit akademik 2012/2013 llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore sjell më së shumti **40 pikë** dhe realizohet në këtë mënyrë:

### **Për dy lëndët externe**

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë provimin e lëndës externe e cila **është e përshtatshme** me programin studimor ku kanë konkuruar, kah nota e çdo lënde externe i shtohet rangui i përqindjes së kandidatit për lëndën përkatëse të pjesëtuar me 20.

- Për kandidatët të cilët në maturën shtetërore kanë dhënë provimin e lëndës externe e cila **nuk është e përshtatshme** me programin studimor ku kanë konkuruar, pikët e asaj lënde të fituara sipas metodologjisë së dhënë shumëzohen me faktor 0,5.

Në bazë të kësaj mund të fitohen më së shumti **20 pikë** nga dy lëndët externe.

### **Për dy lëndët interne**

-Nota e provimit të dhënë nga çdo lëndë interne në maturën shtetërore, e cila **është e përshtatshme** me programin studimor në të cilin kandidati ka konkuruar shumëzohet me koeficient 1,6.

-Nota e provimit të dhënë nga çdo lëndë interne në maturën shtetërore, e cila **nuk është e përshtatshme** me programin studimor në të cilin kandidati ka konkuruar shumëzohet me koeficient 1.

Shuma e fituar në këtë mënyrë mbliidhet

Në bazë të kësaj mund të fitohen më së shumti **16 pikë** për dy lëndët e përshtatshme interne gjegjësisht **13 pikë** për një lëndë të përshtatshme dhe një lëndë jo të përshtatshme dhe **10 pikë** nga dy lëndë jo të përshtatshme.

### **Për detyrën projektuese**

Nota e fituar në detyrën projektuese shumëzohet me një koeficient prej 0.8. Mbi këtë bazë, mund të merren më së shumti **4 pikë**.

❖ Për kandidatët të cilët shkollën e mesme e kanë mbaruar në vitet e mëparshme shkollore (para vitit shkollor 2007/2008) dhe nuk kanë mbaruar maturë shtetërore, përveç llogaritjes së pikëve nga pika 7.a.1), llogariten edhe më së shumti 40 pikë nga lëndët të cilët janë të rëndësishme për programin studimor, edhe atë: shuma e notave nga dy lëndë të rëndësishme për programin studimor (KMSH i përcakton lëndët e rëndësishme për programin studimor) ndahet me numrin e notave (pavarësisht në sa vite lënda është mësuar në shkollë të mesme) dhe kështu, sukcesi mesatar i secilës lëndë veçmas shumëzohet me 4. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti nga **20 pikë** për lëndë, gjegjësisht **40 pikë** për të dy lëndët.

b) Vlerësimi i suksesit në programet studimore me kontrollim të talentit: mbliidhen të gjitha notat që janë përfshirë në dëftesat nga të gjitha vitet dhe provimi i maturës, shuma e fituar pjesëtohet me numrin e notave dhe kështu, sukcesi mesatar i fituar shumëzohet me 12. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti **60 pikë**. Vlerësimi i suksesit nga kontrollimi i talentit bëhet me vlerësim nga **0** deri në **40 pikë**. Kontrollimi ka karakter eliminues me minimum **10 pikë**. Ekzaminimi sipas procedurës së njëjtë do të bëhet edhe për kandidatët e shteteve të huaja, kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut, kandidatët me lëndë jo të përshtatshme interne dhe externe dhe kandidatët që nuk e kanë kaluar maturën shtetërore, gjegjësisht kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit akademik 2007/08.

c) Kandidatët të cilët arrijnë më pak se **40 pikë** nga numri i përgjithshëm i pikëve nuk do të pranohen.

### **III. Seleksionimi i kandidatëve**

1.Për realizimin e Konkursit për regjistrim, Këshilli mësimoro shkencor i fakultetit formon komision për Konkurs.

2. Për përcjelljen e realizimit të Konkursit, Rektorati formon Komision universitar të Konkursit. Komisioni universitar i Konkursit e ndjek realizimin e konkursit të fakulteteve, kujdeset për

respektimin e përpiktë të dispozitave të konkursit, jep udhëzime dhe mendime gjatë realizimit të tij. Komisioni universitar i Konkursit sjell Udhëzues për realizimin e Konkursit.

3. Rangimin e kandidatëve e kryejnë Komisionet e veçanta të fakulteteve.

4. Komisioni për Konkurs, në tabelat e shpalljeve të fakultetit dhe në ueb faqen e Universitetit, e shpall rangimin sipas poenave nga sukcesi i arsimit të mesëm (suksesin mesatar), dhe nga rezultatet e kontrollimit të talentit nga programet studimore në të cilat ai zbatohet (në tabelën e rezultateve do të shpallen edhe të këto të dhëna: emri, emri i prindit dhe mbiemri, vendbanimi, shtetësia dhe statusi i pranimit).

Pas shpalljes së rang listës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs, kandidatët kanë të drejtë për kundërshtim në afat prej 24 orësh. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura. Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike-gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve, dhe i njëjti i drejtohet deri te komisioni i konkursit të njësisë. Komisioni i konkursit të njësisë sjell Vendim pas kundërshtimit. Vendimet mbi kundërshtimet shpallen në Fakultetet.

Nëse kandidati nuk është i kënaqur me Vendimin, në afat prej 12 orësh ka të drejtë të dorëzojë Ankesë deri te Komisioni universitar i Konkursit.

Komisioni universitar i Konkursit në afat prej 24 orëve sjell Vendim për Ankesën.

Vendimi i Komisionit universitar të Konkursit për Ankesën është përfundimtar.

Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve, ose ankesave dhe zgjedhjes së tyre, Komisioni universitar i Konkursit shpall Rang lista përfundimtare për pranimin e studentëve, në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve, nga ana e Komisionit të fakultetit.

Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk do të bëjnë regjistrim, respektivisht nuk do të dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim në shërbimet studentore të fakultetit në të cilin janë pranuar, konsiderohet se kanë hequr dorë nga studimet dhe vendi i tyre do të shpallet si i lirë në Konkursin e radhës.

5. Fakultetet në të cilët edhe pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit do të mbeten vende të paplotësuara, bëjnë regjistrim të studentëve në afatin e dytë dhe të tretë regjistrues.

#### **IV.Regjistrimi i studenteve në kuotë shtetërore**

1. Studentët në kuotë shtetërore do të regjistrohen me pagesë për studime në vlerë prej 200 euro në kundërvlerë denari, sipas kursit të këmbimit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pagesa e e kompensimit, si rregull, bëhet në dy këste të barabarta, kur regjistroni semestrin e dimrit ose të verës.

Kompensimin e përmendur në paragrafin 1 të kësaj pike, studentët të cilët mbajnë statusin e studentëve të rregullt me kuotë shtetërore në përputhje me Statutin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, e parashtrojnë gjatë gjithë kohës së studimeve.

2. Në qoftë se në afatin e parë të regjistrimit gjatë rangimit në fund të listës së kandidatëve të pranuar ka më shumë kandidatë me pikë të barabarta (maksimum pesë kandidatë), fakulteti i regjistron të gjithë kandidatët e tillë. Nëse, megjithatë, numri i kandidatëve të tillë është më i madh se 5, atëherë fakultetet këta kandidatë i rangon sipas kriterëve plotësuese: përshtatshmëria e punimit të detyrës projektuese gjatë dhënies së provimit te mautrës shtetërore, nëse ka fituar çmime në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, anëtarë të ekipeve sportive të RMV-së, nëse kanë marrë certifikata për njohjen e gjuhëve të huaja në një nivel më të lartë, etj.

3. Anëtarët e forcave të sigurisë dhe kategoritë e tjera të personave të përcaktuar me Ligjin për të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të forcave të sigurisë të Republikës së Maqedonisë dhe anëtarët e familjeve të tyre, si dhe personat e përcaktuar nga dispozitat e nenit 23 i të njëjtit ligj (“Gazeta zyrtare e R.M” nr. 02/02, 17/03, 30/04 dhe 66/07 dhe “Gazeta zyrtare e R.M.V.” nr. 53/21), në vitin akademik 2023/2024, do të regjistrohen jashtë kuotës shtetërore pa pagesë të participimit, gjegjësisht kofinancimit nën kushtet e pranimit të përcaktuara në këtë konkurs, dhe numri i tyre nuk mund të tejkalojë më shumë se 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve në programin përkatës të studimeve.

Të drejtën e paragrafit të mëparshëm kandidatët e realizojnë gjatë paraqitjes, me dokument nga Ministria e Mbrojtjes ose nga Ministria e punëve të brendshme. Dorëzimi shtesë i një dokumenti për kandidatët e regjistruar në vitin e parë nuk merret në konsideratë.

4. Institucioni i arsimit të lartë nuk do të paguajë participim për:

- fëmijët pa prindër deri në moshën 26 vjeç nëse janë të papunë;
- personat e shkallës së parë dhe të dytë të aftësisë së kufizuar, në përputhje me dekretin që e sjell Qeveria;
- invalidë luftë;
- persona të rritur në shtëpi për fëmijët e braktisur nën moshën 26 vjeç, nëse janë të papunë; dhe
- persona tjerë të vendosur me dekretin e Qeverisë të sjellur me propozim të Këshillit nacional.

Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, deri në 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt në fakultetin përkatës të përcaktuar në konkurs. Participimi për këta persona do të mbulohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### **V. Regjistrimi i studentëve me koofinancim të studimeve**

1. Në fakultetet, si studentë të rregullt regjistrohen edhe kandidatë që i plotesojnë kushtet për regjistrim, ndërsa për shkak të kufizimit të kuotave nuk mund të regjistrohen në kategorinë e studenteve të financuar nga shteti.

2. Studentët që regjistrohen në këtë kategori, paguajnë kompenzim për studime në vlerë prej 400 euro në kundërvlerë denari, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së, në ditën e pagesës, në së paku 2 këste të barabarta.

Kompenzimin nga paragrafi i mëparshëm i kësaj pike studentët e bartin gjatë gjithë studimit.

3. Fakulteti shpall listën e rangimit të kandidatëve që i plotesojnë kushtet për regjistrim në këtë kategori.

Kandidatët që pajtohen të regjistrohen në këtë kategori studentësh, **dorëzojnë deklaratë** në afat prej 24 orësh pas shpalljes së listës përfundimtare të rangimit, se pajtohen gjatë gjithë kohës së studimeve të marrin pjesë në koofinancim të studimeve.

Listën e kandidateve të pranuar në këtë kategori e vërteton Komisioni i Konkursit në bazë të listës së rangimit dhe deklaratave të dorëzuara për pajtueshmëri për regjistrim në këtë kategori.

Studentët me koofinancim gjatë regjistrimit lidhin kontratë me fakultetin/ Universitetin, për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në realizimin e procesit edukativo-arsimor.

#### **VI. Regjistrimi i studentëve me korrespondencë**

1. Në programet studimore të veçanta në fakultete, si student me korrespondencë mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotesojnë kushtet për regjistrim dhe kanë kontratë për punësim në kohë të pacaktuar, si dhe kandidatët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mundësi të regjistrohen si studente të rregullt.

Si shkaqe të arsyeshme nga paragrafi paraprak llogariten: invalid i cili nuk është në gjendje ta ndjek mësimin e rregullt; sëmundje e rëndë afatgjate, e cila pamundëson vijimin e rregullt të mësimin me tepër se një semester; prind i fëmijes deri sa zgjate pushimi i lehonisë.

2. Studentet me korrespondencë regjistrohen sipas kushteve dhe kritereve të njëjta si studentët e rregullt, ndërsa rangohen në lista të veçanta të rangimit.

Studentët të cilët regjistrohen në këtë kategori, paguajnë kompenzim për studime në vlerë prej 400 euro në kundërvlerë denari, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së, në ditën e pagesës, në së paku 2 këste të barabarta.

Kompenzimin e paguar nga paragrafi 2 i kësaj pike studentët e bartin gjatë gjithë studimit.

3. Gjatë paraqitjes për regjistrim, si studentë me korrespondencë, kandidatët dorëzojnë dëshmi për punësim në kohë të pacaktuar – formularin M1/M2 të noterizuar, ose vërtetim mjekesor për shkaqet e theksuara në pikën 1, paragrafi 2.

#### **VII. Kandidatët me arsim të mesëm të kryer jashtë vendit, kandidatët që kanë kryer maturën ndërkombëtare dhe kandidatët e shkollave të mesme private në RMV.**

**a) Shtetasit e huaj.**

1. Shtetasit e huaj regjistrohen jashtë kuotave të përcaktuara në Konkurs dhe numri i tyre mund të jetë deri 20% nga numri i përgjithshëm i studentëve të përcaktuar me konkurs në nivel të fakultetit, përveç programeve studimore ku mësimi realizohet në gjuhën angleze.

2. Përzgjedhja e shtetasve të huaj që aplikojnë për studiuar në programet studimore në gjuhën angleze, bëhet duke kontrolluar njohuritë dhe aftësitë.

3. Gjatë paraqitjes, kandidatët e theksojnë në cilin fakultet, gjegjësisht program studimor dëshirojnë të studiojnë, se a janë bursistë të qeverisë së tyre, apo vetë i bartin shpenzimet e studimeve. Me fletëparaqitje dorëzojnë diplomë për mbarimin e arsimit të mesëm, si dhe dëftesa për të gjitha klasat, përkthim të vërtetuar të certifikatës së lindjes, vërtetim për njohje të gjuhës maqedonase ose shqipe (të dhënë nga komisioni i Universitetit), dhe vërtetim për gjendjen shëndetësore (HIV test dhe hepatit C). Shtetasit e huaj, për diplomën për mbarimin e shkollës së mesme, si dhe dëftesat për të gjitha klasat, para fillimit të vitit akademik duhet të dorëzojnë vendimin për nostrifikim nga institucioni kompetent i RMV, respektivisht dokumentet për fillimin e procedurës për nostrifikim. Universiteti organizon kurse përgatitore për mësimin e gjuhës shqipe dhe maqedone pranë Qendrës për gjuhë dhe trajnim, ndërsa kandidati i mbulon detyrimet e nevojshme për ndjekjen e kursit. Pagesa e studimeve për shtetasit e huaj për vitin 2023/2024 është 300/500 euro për një semestër respektivisht 600/1000 për një vit akademik. Në këtë kategori të studentëve bëjnë pjesë edhe kandidatët, shtetas të huaj, prindërit e të cilëve apo vetë ata punojnë në përfaqësitë diplomatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

4. Shtetasit e huaj, të cilët kanë kryer arsimin e mesëm në RMV, gjatë përlllogaritjes së pikëve do të trajtohen sipas kriterëve për shtetasit e RMV, por statusi i kandidatit do trajtohet si kandidatët e këtij kreu. Shtetasit e huaj e mbajnë statusin e njëjtë deri në diplomim.

**b) Mërgimtarët dhe shtetasit e RMV me arsim të mesëm të kryer në tërësi, arsim të mesëm të kryer pjesërisht jashtë vendit, kandidatët shtetas të RMV me maturë ndërkombëtare dhe kandidatët me shkollim të mesëm në shkollat private në RMV.**

1. Kandidatët, prindërit e të cilëve janë mërgimtarë tanë dhe kandidatët shtetas të RMV, që arsimin e mesëm të plotë e kanë kryer jashtë vendit regjistrohen jashtë kuotave, me koofinancim të studimeve.

2. Seleksionimi i kandidatëve nga pika 1, kryhet me kontrollim të njohurive dhe aftësive.

3. Kompensimi për studime në këtë kategori të studentëve, në varësi të programeve studimore, është përcaktuar në kreun I të Konkursit (si për kandidatët nga kreu VI), respektivisht 400 euro një vit akademik. Kandidatët të cilët kanë kryer pjesërisht shkollimin e mesëm jashtë vendit, mund të regjistrohen edhe sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Konkurs për kandidatët me arsim të mesëm të kryer në RMV, në kuadër të kuotës shtetërore. Kandidatët nga pika 1, bashkë me fletëparaqitjen dorëzojnë diplomë të nostrifikuar si dhe dëftesa të nostrifikuara për katër vitet e kryera të arsimit të mesëm jashtë vendit.

4. Kandidatët shtetas të RMV, me maturë të mbaruar ndërkombëtare, regjistrohen me kushte dhe kriterë të njëjta, si dhe kandidatët me shkollë të mesme të mbaruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me atë që përveç dokumenteve të tjera, dorëzojnë edhe dëftesa të nostrifikuara për pjesën e arsimit të mesëm të kryer jashtë vendit, gjegjësisht për maturë të kryer ndërkombëtare. Këta kandidatë rangohen në rang - listë të veçantë, kurse do të pranohen ata kandidatë të cilët do të fitojnë aq pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kuadër të kuotës shtetërore në programin studimor përkatës. Numri i këtyre kandidatëve mund të arrijë më së shumti 10%, kurse shpenzimet për studimet e tyre i bartë Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kandidatët të cilët kanë fituar pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kategorinë me koofinancim të studimeve, regjistrohen me kompensim për studime në lartësi të përcaktuar sipas kreut I të Konkursit. Për kandidatët të cilët regjistrohen në këtë kategori, me koofinancim të studimeve, vlejnjë dispozitat nga kreu VI i Konkursit. Kandidatët nga kreu i VII (b), paraqiten në Rektoratin e UNT-së, në afatet e përcaktuara me Konkurs.

5. Kandidatët të cilët kanë kryer shkollimin e mesëm në shkolla private të akredituara në RMV, me maturë shtetërore, do të trajtohen njëjtë si kandidatët të cilët kanë kryer shkollimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



## VIII. Kuotat plotësuese të cilat i përcakton Qeveria e Republikën e Maqedonisë së Veriut

1. Numri i studentëve, që i takojnë kategorisë së personave me të drejta të veçanta të përcaktuara me Ligjin për të drejta të veçanta të RMV, regjistrohen në kuotë të veçantë (pa bartje të shpenzimeve për studime), numri i tyre mund të arrijë më së shumti 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve në nivel të programit studimor.

2. Për sigurimin e përfaqësimit të drejt të kandidatëve të cilët u takojnë bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në institucionet e larta të Universitetit, në vitin akademik 2023/2024, në mënyrë plotësuese do të regjistrohen kandidatët të cilët u takojnë këtyre bashkësive, numri i të cilëve të mos e kalon 10 % nga numri i përgjithshëm i studentëve të cilët regjistrohen në vitin e parë në nivel të fakultetit. Në kuadër të kësaj përqindjeje, në mënyrë të drejtë do të përfaqësohen kandidatët e të gjitha bashkësive, deri në përqindje me të cilin bashkësia përkatëse është përfaqësuar në numrin e përgjithshëm të banorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3. Përqindja e studentëve - përfaqësues të këtyre bashkësive, sëbashku edhe në kuotën shtetërore edhe në atë plotësuese, duhet të jetë deri në përqindje me të cilin bashkësia përkatëse është përfaqësuar në numrin e përgjithshëm të banorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## IX. Afatet për paraqitje dhe regjistrimi:

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTEVE - 2023/2024 NË AFATIN E I-rë	
Aplikimi (paraqitja e kandidatëve)	24-30 Gusht
Shpallja e rezultateve preliminare	31 Gusht
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	01 Shtator
Regjistrimi i studentëve	04-08 Shtator

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTEVE - 2023/2024 NË AFATIN E II-të	
Aplikimi (paraqitja e kandidatëve)	11-14 Shtator
Shpallja e rezultateve preliminare	15 Shtator
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	18 Shtator
Regjistrimi i studentëve	18-22 Shtator

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTEVE 2023/2024 NË AFATIN POLTËSUES	
Aplikimi (paraqitja e kandidatëve)	25 Shtator
Shpallja e rezultateve preliminare	26 Shtator
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	27 Shtator
Regjistrimi i studentëve	27-29 Shtator

## SHËNIM:

Pas realizimit të afatit të parë të regjistrimit, për vendet e pa plotësuar në fakultete, përkatësisht në programet studimore, Universiteti, në faqen e internetit do të shpall numrin e vendeve të lira për regjistrim në afatin e dytë të regjistrimit për vitin akademik 2023/2024.

Pas realizimit të afatit të dytë të regjistrimit, për vendet e pa plotësuar në fakultete, përkatësisht në programet studimore, numrin e vendeve të lira për regjistrim në afatin e tretë të regjistrimit për vitin akademik 2023/2024, do të shpallet në faqen e internetit të Universitetit.

## X. Dokumentet për aplikim dhe regjistrim:

Për aplikim dhe regjistrim në fakultete kandidatët dorëzojnë dokumentet në vijim:

1. Fletëaplikim (merret në hapësirat e Universitetit);
2. Dëftesa origjinale nga shkollimi i mesëm, për të gjitha klasat;
3. Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme;
4. Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
5. Certifikatë për nënshtetësi;
6. Vërtetim për pagesat e:

a) **800 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.

b) **600 denarë** mjete plotësuese për secilën lëndë të cilës kandidatët do të nënshtrohen për provim pranues të theksuar në Listën shtesë -1, të Programit studimor përkatës, ku është paraparë provimi pranues: në emër të Komisionit për verifikimin e njohurive dhe aftësive dhe intervistimit (për programet në gjuhën angleze).

Kandidatët që aplikojnë në programet ku mundësohen studime me korrespondencë, krahas dokumentacionit të caktuar më lartë, duhet të dorëzojnë dokumentet përkatëse për arsyetimin e këtij statusi sipas kritereve të përcaktuara në këtë konkurs.

**Kandidatët të cilët janë të pranuar (pas shpalljes së listës përfundimtare), gjatë regjistrimit duhet të dorëzojnë:**

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në fakultet)
2. Tre fotografi (dy fotografi 6x9 dhe një – 4x5cm)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
  - ❖ **100 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të parlamentit studentor.
  - ❖ **800 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Indexit.
  - ❖ **750 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.
  - ❖ **Pagesën e mjeteve për semestrin e parë.**

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhiro-llogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

- ❖ Në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti “Nënë Tereza” – Shkup;
- ❖ Në “banka e marrësit” (**банка на примач**) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;
- ❖ Në “llogaria” (**сметка**) – 100000000063095;
- ❖ Në “shuma” (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhet;
- ❖ Në “llogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues” (**сметка на буџетски корисник – единка корисник**) – 1600162677 788 15;
- ❖ Shifra (Приходна шифра) 723012, programi (програма) 45.

**KONKURSI ËSHTË SHPALLUR EDHE NË WEB-FAQEN WWW.UNT.EDU.MK**

### Shtojca 1

Lista e lëndëve të përshtatshme externe dhe lëndëve interne nga matura shtetërore për aplikim për regjistrim në programet studimore në Universitetin "Nënë Terezës" në Shkup, për kandidatët që kanë dhënë provimin e maturës shtetërore nga viti akademik 2023/2024 deri më sot.

1. Për të gjithë kandidatët provim i detyrueshëm extern është lënda: gjuhë dhe letërsi maqedonase dhe gjuhë dhe letërsi shqipe dhe gjuhë dhe letërsi turke.

2. **Lënda e parë externe** për kandidatët me arsim të mesëm të përgjithshëm (gjimnaz) dhe me arsim të mesëm profesional: matematikë ose gjuhë të huaj, dhe për kandidatët me arsim të mesëm në shkollë arti është: gjuhë e huaj ose estetikë / filozofi.

3. **Lëndët zgjedhore interne** për pjesën zgjedhore të matures shtetërorenë arsimin gjimnazik: Matematika, gjuha e huaj (anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe rusisht), Fizik, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, gjuhët klasike, Arti figurative, Arti muzikor, Filozofia, Sociologjia, Informatika-me teknologjinë informatike (2+2 orë), Gjuha Maqedone dhe Literatura (për nxënësit që e ndjekin mësimin në gjuhë shqipe ose në gjuhë turke).

**Lëndët mësimore zgjedhore** për pjesën e matures shtetërore në arsim profesional të mesëm: Matematika, gjuha e huaj (anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe rusisht), Fizik, Kimi, Biologji, Biznes dhe Histori.

**Lëndët mësimore zgjedhore** për pjesën e matures shtetërore në arsim artistik të mesëm: gjuha e huaj (anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe rusisht), Histori, Filozofia dhe Estetika.

Fakultet	Lënda e dytë eksterne zgjedhore	Lënda interne zgjedhore
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE INFORMATIKE</b>		
Informatikë	Pa kufizim	Informatika, matematika ose gjuha e huaj (së paku një, por mundet edhe dy lëndë); Një lëndë sipas zgjedhjes së kandidatit, pa kufizim
Informatikë- mësimdhënie	Pa kufizim	Informatika, matematika ose gjuha e huaj (së paku një, por mundet edhe dy lëndë); Një lëndë sipas zgjedhjes së kandidatit, pa kufizim
Programim i aplikuar	Pa kufizim	Informatika, matematika ose gjuha e huaj (së paku një, por mundet edhe dy lëndë); Një lëndë sipas zgjedhjes së kandidatit, pa kufizim
<b>FAKULTETI I SHKENACVE TEKNOLOGJIKE</b>		
Inxhinieri e materialeve dhe nanoteknologjive	Pa kufizim	Pa kufizim
Teknologjia ushqimore	Pa kufizim	Pa kufizim

Agroinxhineria		Pa kufizim	Pa kufizim
Tekstil dizajn dhe modelimi		Pa kufizim	Pa kufizim
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE</b>			
Sistemet elektroenergjetike (Elektroenergjetika dhe burimet e ripërtrishme të energjisë 1)		Pa kufizim	Pa kufizim
Inxhinieri makinerike dhe manaxhment (dizajni I qëndrueshëm në inxhinerinë e makinerike 1)		Pa kufizim	Pa kufizim
Inxhinieri e transportit dhe komunikacionit		Pa kufizim	Pa kufizim
Mekatronikë		Pa kufizim	Pa kufizim
Menaxhment industrial		Pa kufizim	Pa kufizim
Ekonomi e zbatuar dhe ndërmarrësi		Pa kufizim	Pa kufizim
Inxhinieria për mbrojtje të ambientit të punës dhe jetesës		Pa kufizim	Pa kufizim
Profili	Inxhinieria për mbrojtje të ambientit		
	Inxhinieria për mbrojtje të shëndetit gjatë punës		
<b>Programi studimor ndër-disciplinar në Universitetin “Nënë Tereza “ në Shkup</b>			
Dogana, shpedicion dhe sigurime		Pa kufizim	Pa kufizim
<b>FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS</b>			
Arkitekturë dhe dizajn		Pa kufizim	Pa kufizim
Ndërtimtari- konstruktive		Pa kufizim	Pa kufizim
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE</b>			
Punë dhe politikë sociale		Pa kufizim	Pa kufizim
Media dhe komunikim ndërkulturor		Pa kufizim	Pa kufizim
Sport dhe shkencat e sportit		Pa kufizim	Pa kufizim
Studime Ballkanike dhe Euroaziatike		Pa kufizim	Pa kufizim
Administratë publike dhe menaxhim me burimet njerëzore		Pa kufizim	Pa kufizim
Studime politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (në gjuhë angleze)			Pa kufizim